

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr.102 Date 16.3.1992

PER

NORMAT E PERDORIMIT DHE ÇMIMIN E UJIT TE PIJSEM NE QYTET  
DHE NE FSHAT

Me propozimin e Drejtorise se Pergjithshme te Ekonomise  
Komunale, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Normat e perdorimit te ujit te pijshem per efekt pagese per perdoruesit familjare, te cilet nuk kane mates, te jene :
  - a) 150 litra uje ne dite per fryme (ne banesat me instalimer te brendshme hidrosanitare);
  - b) 60 litra uje ne dite per fryme per banesat pa instalime te brndshme hidrosanitare dhe per familjet qe marrin uje nga cezmat e perbashketa).
2. Çmimi i shitjes se ujit te pijshem per popullsine ne qytet e ne fshat te jete 1 (nje) lek per m3 te harxhuar. Sasia e konsumuar mbi normative te paguhet me 2-fishin e cmimit te caktuar.
3. Per tyremujorin e dyte te vitit 1992 te financohet nga buxheti i shtetit diferenca ndermjet cmimit te shitjes dhe kostos se prodhimit te ujit ne fshat per shumen 60 milione leke. Keto fonde te perbalohen nga rritja e deficitit buxhetor te tremujorit te dyte te ketij viti.
4. Per ndermarrjet sipas listes qe i bashkelidhet ketij vendimi, te financohet humbja per 5 milione leke. Keto fonde te perballohen nga rritja e deficitit buxhetor te tremujorit te dyte te ketij viti.
5. Çmimi i ujit te pijshem qe perdorin personat juridike e fizike per nevojat shtetore a veprimtari private, caktohet deri ne 60 leke/m3 uje te harxhuar.
6. Aparati mates i ujit ne ndermarrjet ekonomike, institucionet e personat e tjere juridike e fizike vendoset nga vete perdoruesi, pas miratimit te vendvendosjes dhe regjistrimit te aparatit nga ndermarrja shitese e ujit. Aparatet matese ne keto raste i perkasin ndermarrjeve ekonomike qe perdorin ujin e pijshem.

Ne mungese te aparatit mates te ujit, faturimi behet ne baze te sasise se ujit se ujit per te cilin eshte lidhur kontrate ndermjet ndermarrjes shitese dhe perdoruese, me cmimet e parashikuara ne piken 4 te ketij vendimi.

7. Ministria e Financave dhe Drejtoria e Pergjithshme e Ekonomise Komunale te nxjerrin udhesimin perkates per zbatimin e ketij vendimi.

8. Neni 2 dhe neni 4 i v.K.M. nr.254, date 7.7.1989 persa i perket ujit te pijshem e teknologjik, si dhe pika 6 e v.K.M. nr.58. date 14.9.1978, shfruqizohen.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

VILSON AHMETI